REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
REP. 752 NR.
KOL. 131 NR.

Taksa u pagua ne ... u likuidua

**KONTRATE SHITBLERJE**
**AKSIONESH**

Ne Tirane sot me date 21 MAJ ......2007 (Dymije e shtate ), para meje notere L. QUSTINA , e regjistruar ne dhomen e Notereve Tirane ne zyren e noterise Rruga "Deshmoret e 4 Shkurtit" Nr.26/1, u paraqiten personalisht palet e poshteshenuara, te cilet kerkuan redaktimin e kesaj kontrate shitblerje aksionesh, si vijon :

**S H I T E S I:**
Shoqeria **RIRAsha** eshte krijuar si person juridik me vendim te Gjykates se Rrethit Tirane Nr.21426, date 02.06.1999, me seli ne Tirane, Rruga "Ali Demi" Nr.49, e perfaqesuar nga Z. Xhevat Rira

**B L E R E S I:**
Shoqeria **GSAshpk** eshte krijuar si person juridik me vendim te Gjykates se Rrethit Tirane Nr.674, date 30/06/1993 , me seli ne Tirane, e perfaqesuar nga Z. Agron Shapllo.

**O B J E K T I:**
Shitja e **865 787 aksioneve** te zoteruara nga **RIRAsha** ne shoqerine "Porto Romano Oli" ShA (**PROsha**) bleresit shoqerise **GSAshpk.**

**B A Z A L I G J O R E:**
Neni 204 e vijues te Ligjit per Shoqerite Tregtare Nr. 7638 date 19/11/1992.

Shoqeria **PROsha**, rezulton e themeluar me vendim te Gjykates se Rrethit Gjygjesor Tirane Nr. 34742 date 17.01.2006, me aksioner te vetem shoqerine **RIRAsha** dhe me kapital themeltar 892,564,000 (teteqind e nentedhjete e dy milione e peseqind e gjashtedhjete e katermije) leke.

Shitesi **RIRAsha** i shet bleresit **GSAshpk** **865,787 aksione** (teteqind e gjashtedhjete e pese mije e shtateqind e tetedhjete e shtate) qe perfaqesojne 97% te kapitalit themeltar te **PROsha** kundrejt shumes prej

**868,384,361** leke (teteqind e gjashtedhjete e tete milone e treqind e tetedhjet e kater mije e treqind e gjashtedhjet e nje leke).
Cmimi i shitjes se nje aksioni eshte nje aksion me 1,003 leke (nje mije e tre) dhe kursi i kembimit per efekt llogaritje eshte 1 USD = 100 leke.
Shlyerja e shumes prej **868,384,361** leke nga ana e bleresit **GSAshpk** per blerjen e aksioneve do te behet si me poshte:

**A) 154,000,000 leke** (100 leke/USD X 1,540,000 USD =154,000,000 leke) shume si detyrim i Shitesit ndaj Bleresit (shume me te cilen eshte kredituar Shitesi nga Bleresi gjate periudhes 2000 – 2006 sipas bilanceve te te dy shoqerive) dhe qe aktualisht konsiderohet e likujduar;

**B)** Shuma e mbetur prej **714,384,361 leke**, do te shlyhet sipas nje marreveshje dy paleshe midis **RIRAsha** dhe **GSAshpk**.

Palet bien dakord qe kalimi i pronesise se aksioneve te behet menjehere pas nenshkrimit te kesaj kontrate.
Me neshkrimin e kesaj kontrate Shitesi **RIRAsha** ngelet zotrues i **26,777** askioneve qe perfaqesojne **3%** te kapitalit themeltar te **PROsha**.
Bleresi **GSAshpk** behet zoterues i **865,787 aksioneve** qe perfaqesojne **97%** te kapitalit themeltar te **PROsha**.

Paleve te sipershenuara ju lexua dhe shpjegua permbajtja e kesaj kontrate, e pelqyen ate dhe me vullnetin e tyre te lire e te plote e nenshkruajne rregullisht konform ligjit dhe une noteria e vertetoj me nenshkrimin tim dhe vulen e noterit publik sipas Ligjit per Noterine Nr. 7628 date 01/06/1994.

**P A L E T**

**S H I T E S**
**RIRA SHA**
Xhevat Rira
Nimet Rira
Edmond Rira

**B L E R E S I**
**GSA SHPK**
Agron Shapllo
Serafin Orgocka
Ilir Tifekciu

**NOTERE**